



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË ELBASAN
TË Z. ALBERT RRAPUSH SHOPI PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERDHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan z. Albert Rrapush Shopi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a" neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për Anëtar në Këshillin e Bashkisë si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", z. Albert Rrapush Shopi ka depozituar në KQZ "Kërkesën për regjistrim si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan".

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e Bashkisë Elbasan, pasi Bashkia Elbasan, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për regjistrim e z. Albert Rrapush Shopi si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;



Nr. 595 i Vendimit

Data 19.05.2019

Ora 16:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan, z. Albert Rrapush Shopi për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

3. Vërtetim i Këshillit të Bashkisë Elbasan, nr. 16/5 prot., datë 16.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se z. Albert Rrapush Shopi është zgjedhur në Këshillin e Bashkisë Elbasan;
4. Karta e identitetit e z. Albert Rrapush Shopi me nr.personal F01030073A.
5. Jetëshkrimin e z. Albert Rrapush Shopi si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Z. Albert Rrapush Shopi, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 13.05.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 4223.

Në zbatim ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatin për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Albert Rrapush Shopi, rezulton se nuk ka deklaruar të dhën që përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tij sipas ligjit 138/2015.

KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve z. Albert Rrapush Shopi nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 19.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit kandidatin për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z. Albert Rrapush Shopi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

